



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:055157
Datë: 11.04.2024
Numri i dokumentit: 05563076

Ac.nr.1071/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli, kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.B. nga Gjilani të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.N. avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën e përfaqëson Burim Maliqi zyrtar i lartë ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.1158/2020, të datës 06.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit e paraqitur në drejtim të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.1158/2020, të datës 26.11.2021, përkitazi me detyrimin e të paditurës që në emër të shujtave ditore për 735 ditë pune paditësit t'i paguaj shumën prej 1470€, ashtu që aktgjykimi në këtë pjesë VËRTETOHET
- II. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.1158/2020, i datës 06.12.2021 në pikën I (një) të dispozitivit përkitazi

me detyrimin e të paditurës që në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune paditësit t'i paguaj 75% të pagës bazë dhe lënda për këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1158/2020, të datës 06.12.2021, ka vendosur si në vijim:

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.B. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të kërkesës për kompensim të shpërblimit jubilar mbi 20 vite përvojë pune t'ia paguaj (75% të pagës bazë), përkatësisht shumën prej 371.47euro, si dhe në emër të kërkesës për kompensim të ushqimit në punë shumën prej 1,470.00euro, gjithsej shumën e përgjithshme për dy kërkesat e cekura më sipër në lartësi prej 1,841.47euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit Sh.B. ,nga Gjilani, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 269euro,e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e të paditurës dhe ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, apo ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi duke i kontestuar në tërësi të pabazuara pretendimet ankimore të të paditurës, me propozim që ankesa të refuzohet, aktgjykimi i atakuar të vërtetohet dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 80euro në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi Sh.B. nga Gjilani, me datë 20.05.2020, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit ka ushtruar padi me bazë juridike për pagë jubilarë dhe kompensim të shpenzimeve të ushqimit, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën për administrimin e provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe mbi bazën e provave të nxjerra ka vlerësuar se kërkesa nga padia është e bazuar, prandaj të njëjtën e aprovoi në tërësi duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit gjykata ka parashtruar se paditësi ka mbi 23 vite përvojë pune tek e paditura, ndërsa nga marrëdhënia e punës realizon pagë mujore neto në vlerë prej 495euro. Gjithashtu gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestues që paditësi gjatë periudhës kohore prill 2017 - Janar 2021 ka realizuar gjithsej 735 ditë pune. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar dhe me referim në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit (KKA), gjykata e detyroi të paditurën që paditësit t'ia paguaj 75% të një page bazë në emër të shpërblimit jubilar në lartësinë e provuar të pagës neto si dhe shumën nga dy euro për çdo ditë të realizuar në punë, e cila shumë i referohet kompensimit të shujtës ditore për të cilën e paditura, në bazë të KKA, detyrohet t'i paguaj të punësuarve në institucionet arsimore.

Gjykata e Apelit pretendimet ankimore të të paditurës të paraqitura në drejtim të aktgjykimit në pjesën me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit për pagesën e shpenzimeve të ushqimit i ka gjetur si të pambështetura pasi dispozitivi i aktgjykimit në pjesën e atakuar është i qartë, në aktgjykim janë treguar faktet dhe arsyet vendimtare për aprovimin e kërkesëpadisë, e të cilat fakte nuk kanë qenë kontestuese mes palëve ndërgjyqëse, respektivisht nuk ishte kontestuese që paditësi kishte realizuar 735 ditë pune, ndërsa e paditura nuk i ka kompensuar shpenzimet e ushqimit për ditët e prezencës në punë, përkundër detyrimit nga dispozitat e KKA.

Në rastin konkret kërkesëpadia ka mbështetje ligjore në dispozitat e nenit 90 parag.1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, ku përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me parag.1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me parag.4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive". Për më shumë, baza juridike e kërkesëpadisë gjen mbështetje në dispozitat e nenit 35 paragraf 7, të KKA datë 18.04.2017, ku përcaktohet se: "*Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*". Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se në këtë rast ekziston detyrimi

juridik - civil, ndaj paditësit për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit i ka pranuar si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës në pjesën e aprovuar të kërkesëpadsisë sa i përket shpërblimit jubilar pasi siç rezulton nga shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar gjendjen faktike sa i përket përvojës së punës së paditësit të e paditura dhe, si rezultat i gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë jo të plotë ka aplikuar gabimisht edhe të drejtën materiale, duke e detyruar të paditurën që për njëzetë vite përvojë pune, paditësit t’i paguaj 75% të pagës bazë ashtu siç parashihet në dispozitat e nenit 35.8 të KKA. Në këtë drejtim, gjykata ankimore përkujton se sipas dispozitave të KKA, në fuqi në kohën e parashtrimit të padsisë, punëdhënësi në të vërtetë ka pasur për detyrim që punëmarrësit t’i shpërblej pagën jubilarë, në raport me vitet e punës, me kusht që i punësuarit të ketë arritur jubileun të punëdhënësi i fundit. Duke qenë se kërkesat e tilla janë në para dhe rrjedhin nga marrëdhënia e punës, si rregull të njëjtat duhet të parashtrohen brenda afatit ligjor të përcaktuar si në nenin 87 të Ligjit për punë. Mirëpo, në rastin konkret gjykata ankimore konstaton se në mungesë të provave materiale, faktet vendimtare lidhur me përvojën e punës së paditësit nuk kanë mundur të vërtetohen, pasi paditësi në padinë e parashtruar në vitin 2020, ka deklaruar se ka përvojë pune gjithsej 23 vite, ndërkaq nga lista e pagave rezulton se 23 vite përvojë pune kishte edhe në vitin 2018. Kështu, për sqarimin e viteve të sakta të përvojës së punës dhe vlerësimin e kundërshtimit të vjetërsimit të kërkesës, gjykata shkallës së parë domosdoshmërisht është dashur të administroj prova materiale për të konstatuar nëse kushtet ligjore për shpërblimin jubilar plotësohen në rastin e paditësit. Prandaj për shkak të mangësive në të cilat konsiston aktgjykimi i ankimuar, i njëjti në këtë pjesë është dashur të priset, në mënyrë që në rigjykim të konstatohen faktet vendimtare sa i përket përvojës së punës së paditësit, kohës së arritjes së jubileut dhe nëse në atë kohë ka ekzistuar detyrimi i punëdhënësit që të punësuarve t’ia shpërblej pagën jubilarë dhe përfundimisht nga gjykata e shkallës së parë të vlerësohet nëse kërkesa është parashkruar pasi e paditura që në fillim të procedurës kontestimore ka paraqitur kundërshtimin përkitazi me parashkrimin e kërkesës, ndërsa gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit nuk ka dhënë ndonjë vlerësim në drejtim të këtij kundërshtimi.

Nën rrethanat e tilla të konstatuar, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e që ka ndikuar edhe në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Si rrjedhojë, për shkak se aktgjykimi në këtë pjesë përshihet në shkëlqet e pretenduara si në ankesën e të paditurës, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë krijuar kushtet ligjore që aktgjykimi të ndryshohet, por nga arsyet e parashtruara më sipër, është dashur që aktgjykimi i atakuar të priset në pjesën e aprovuar të kërkesëpadsisë përkitazi me shpërblimin jubilar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në riprocedurë të veprtojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që fillimisht të vërtetojë gjendjen faktike se kur paditësi ka arritur 20 vite përvojë pune dhe në kohën e arritjes së jubileut a ka ekzistuar baza juridike për realizimin e kërkesës nga padia. Në fund, në raport me faktet vendimtare dhe pas vlerësimin të

kundërshtimeve në drejtim të parashkrimit të kërkesës, gjykata duke aplikuar normat e së drejtës materiale të merr vendim meritor i cili në strukturë dhe përmbajtje duhet të jetë në pajtim me dispozitat nga neni 160 të LPK-së.

Nga arsyet e theksuara, Gjykata e Apelit në kuptim të dispozitës nga neni 194, 195 pika d) dhe c) e LPK vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1071/2022 me datë 04.04.2024

Kryetare e kolegjit

Hunaida Pasuli